

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vlora Hyseni qëndroi në Kosovë gjatë ditës? Rexha: Kosova nuk ka linja fluturimi me Azerbaixhanin - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/vlora-hyseni-qendroi-ne-kosove-gjate-dites-rexha-kosova-nuk-ka-linja-fluturimi-me-azerbaixhanin/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:48:32 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	22 shtator 2026, 19:25:41 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c684916e38f397e363fddb85da473479b694cf7b1c22e86ebbf4be150a8d2b23
TEKSTI	084eae3489ce83454401dde4fc7c2c6b885ec8a491853105c8bb1f2ef936e839
PAMJA	1044a9b6c331b93f2689bf1d71be40c8190926c1b6f87cc831d0d40cbe6bdab4

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	50d7dad6cc7178c292b9e7595dea9906375f3c36dca0ec12b9eaba407a9f3d5
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/50d7dad6cc7178c292b9e7595dea9906375f3c36dca0ec12b9eaba407a9f3d5

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Donald Trump SHBA Asambleja e OKB Lufta në Ukrainë Sali Berisha

AKTUALITET | KOSOVË

Vlora Hyseni qëndroi në Kosovë gjatë ditës? Rexha: Kosova nuk ka linja fluturimi me Azerbajxhanin



22 Shtator 2026 | 21:25

Gazetari Xhemajl Rexha në një lidhje direkte për emisionin "Now me Erla Mëhillin" në Euronews Albania ka bërë të ditur detaje të tjera lidhur me dorëzimin e Vlora Hysenit.

Rexha raportoi se Hyseni ka qenë gjatë ditës brenda territorit të Kosovës, por ajo ka kaluar në pikën kufitare të Morinës në mbrëmje duke u dorëzuar tek autoritetet shqiptare. Ai sqaroi më tej se pala kosovare nuk ka të bëjë me ngjarjen pasi për aq kohë sa Hyseni është ndodhur brenda territorit të Kosovës, nuk ka pasur asnjë direktivë nga autoritetet shqiptare për ta arrestuar atë.

"Nga informacionet që sapo kam arritur të marr nga burime brenda Kosovës më shumë pra që zonja Hyseni ka qenë gjatë ditës në territorin e Kosovës dhe nuk ka pasur një urdhër arresti brenda territorit të Republikës së Kosovës në mënyrë që ajo të ndalohej dhe ajo e ka kaluar në orët e mbrëmjes kufirin mes Kosovës dhe Shqipërisë meqë jemi ende në periudhën e verës në të cilën kontrollet janë më të pakta.

Zonja Hyseni është e konfirmuar tashmë që është dorëzuar tek autoritetet shqiptare, pra nuk ka pasur asnjë lloj pune Kosova, as Policia e Kosovës e as autoritetet në Kosovë. Zonja Hyseni e ka kaluar kufirin dhe është ndalur tek autoritetet shqiptare në pjesën shqiptare të kufirit ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë në Vërnice, në pikën kufitare Morinë.

Sipas informacioneve ka kaluar kufirin dhe është nisur. Pala kosovare nuk ka punë me të pasi që nuk ka pasur asnjë kërkesë nga autoritetet shqiptare gjatë ditës me gjasë për palën kosovare që nëse ajo është në territorin e Kosovës të ndalohej", u shpreh ai.

Përsa i përket dyshimeve rreth itinerarit të saj përpara dorëzimit, Rexhaj u shpreh se Kosova nuk ka asnjë linjë direkte ajrore me Azerbajxhanin.

"Ende nuk dihen detaje për itinerarin e saj, Kosova nuk ka asnjë lidhje të linjave ajrore me Azerbajxhanin. Mund të ketë përdorur ndonjë linjë të ndërmjetme që kryesisht është Viena e Austrisë, nuk e kam konfirmuar, po e them si mundësi që kjo është pika kryesore për udhëtarët e Kosovës", shtoi ai.

Shiko në:

LAJMI I FUNDIT

20:48 Vijn protestat në Tiranë në ditën e 116-të, nesër tubim para Kuvendit

20:28 Kapet në Rusi 'bosi' shqiptar i 'kartelit' te drogës Shpëtim Aliu

20:16 Administrata Trump po përgatit planin për ndalimin 90-ditor të eksporteve të naftës

20:11 Trump zbulon marrëveshje SHPERNDAJE eksionesh me vlerë miliona ARTIKULLIN dollarë në industrinë e teknologjisë dhe AI

20:05 Shtetet Baltike i kërkojnë BE-së 500 milionë euro për mbrojtjen kundër dronëve

19:51 Moska refuzon armëpushimin, Lavrov: Rusia nuk do t'i ndalë luftimet

TESTIM

LAJME TË SUGJERUARA

AKTUALITET | VENDI

Vijon protesta në Tiranë në ditën e 116-të, nesër tubim para Kuvendit

Protesta qytetare në Tiranë këtë të mërkurë hyri në ditën e saj të 116-të. Ashtu sikurse e kanë nisur që prej orës 19:30, si fillim...

20:48 | 23/09/2026

AKTUALITET | EURONEWS ALBANIA | LAJM KRYESOR | VENDI

Kapet në Rusi 'bosi' shqiptar i 'kartelit' te drogës Shpëtim Aliu

Është arrestuar në Rusi, me qëllim ekstradimi, Shpëtim Aliu, i njohur edhe me emrin Salvatore, i shpallur në kërkim nga SPAK si drejtues i një...

20:28 | 23/09/2026

AKTUALITET | VENDI

Tatimet vijnë rimbursimin e tatimit të mbipaguar, rreth 2200 përfitues

Administrata Tatimore po vijon procesin e rimbursimit të tatimit të mbipaguar për individët në kuadër të Deklaratës Individuale Vjetore të të Ardhurave (DIVA) për vitin...

18:12 | 23/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni
Punësimi

Follow Euronews on all platforms:

Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.